



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 180

Tiranë – E enjte, 14 dhjetor 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 731, datë 13.12.2023	Për dhënien e statusit të veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special”, aplikuesit “ <i>White Roads Hotel</i> ” sh.p.k..... 21815
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 54, datë 7.11.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-4482(385), datë 15.11.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 21815
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 55, datë 7.11.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2649, datë 3.11.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë..... 21822



VENDIM

Nr. 731, datë 13.12.2023

**PËR DHËNIEN E STATUSIT TË
VEÇANTË “INVESTITOR NË
STRUKTURË AKOMODUESE ME 5 YJE,
STATUS SPECIAL”, APLIKUESIT
“WHITE ROADS HOTEL” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33/1, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e statusit të veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special”, aplikuesit “White Roads Hotel” sh.p.k.

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për turizmin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 54, datë 7.11.2023

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Sandër Beci	anëtar,
Marjana Semini,	anëtare.

me sekretare Belma Lleshi, në datën 7.11.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 14 (A) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Aleksandër Rrozhani

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Durrës

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-4482(385), datë 15.11.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, pika 1, 42, 44, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, pikat 2 dhe 5 dhe 71/a, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuësit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (*DPPSH*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, Durrës (*DRKM*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Aleksandër Rrozhani është pranuar në Policinë e Shtetit në datën 1.12.1998. Kjo marrëdhënie ka vijuar deri në daljen e urdhrin nr. 1549 prot., datë 17.5.1999 (*urdhri nr. 1549/1999*) të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit (*drejtori i DPPSH-së*), me të cilin kërkuesi është përjashtuar nga Policia e Shtetit me motivacionin “*Shkelje të betimit*” dhe “*Braktisje të detyrës*”. Ai është ripranuar në Policinë e Shtetit me urdhrin nr. 978/3 prot., datë 25.9.2001, të drejtorit të DPPSH-së (*urdhri nr. 978/3/2001*), marrëdhënie e cila ka vazhduar deri në daljen e urdhrin nr. 219/1 prot., datë 15.4.2014 të drejtorit të DPPSH-së (*urdhri nr. 219/1/2014*), me të cilin është urdhëruar lirimi i tij nga policia, kohë kur ai kryente detyrat në DRKM-në, Durrës. Lirimi i kërkuësit nga policia sipas urdhrin nr. 219/1/2014



është motivuar mbi shkakun se ripranimi i tij në polici është bërë në shkelje të nenit 20, pika 2, të ligjit nr. 8553, datë 25.11.1999, “Për Policinë e Shtetit” (*ligji nr. 8553/1999*), të nenit 57, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit” (*ligji nr. 9749/2007*) dhe të nenit 46 të Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit, të miratuar me vendimin nr. 804, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave (*VKM-ja nr. 804/2007*). Fillimisht, urdhrin e lirimit nga policia kërkuesi e ka kundërshtuar në rrugë administrative, duke paraqitur ankim në Komisionin e Apelit të DPPSH-së, i cili, me vendimin nr. 451, datë 21.7.2014 (*vendimi nr. 451/2014*), ka vendosur lënie në fuqi të urdhrit nr. 219/1/2014 të Drejtorit të DPPSH-së. Më pas, kërkuesi ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nëpërmjet së cilës ka paditur DPPSH-në, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr. 219/1/2014 të Drejtorit të DPPSH-së, të lënë në fuqi me vendimin nr. 451/2014 të Komisionit të Apelit të DPPSH-së, si dhe zgjidhjen e pasojave përmes detyrimit të DPPSH-së për ta rikthyer në detyrën e mëparshme dhe pagimin e pagës nga data 16.4.2014 deri në datën e rimarrjes në detyrë.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 6488, datë 12.11.2014, ka vendosur të shpallë moskompetencën tokësore për shqyrtimin e çështjes, duke dërguar padinë dhe aktet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, si gjykata kompetente. Kjo e fundit, pasi ka regjistruar çështjen, ka pranuar kërkesën e kërkuesit dhe thirrur si të paditur në proces edhe DRKM-në, Durrës, si dhe ndryshimin e kërimit për zgjidhjen e pasojave në objektin e padisë, konkretisht detyrimin e palës së paditur për t’i paguar atij dëmshpërblimet si vijon: i. pagën e një viti për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të kontratës individuale të punës; ii. pagën e tre muajve për mosrespektimin e afatit të njoftimit; iii. pagën e dy muajve për mosrespektimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës; iv. gjysmë page mujore për çdo vit të plotë pune, për vjetërsinë në punë.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. 249, datë 26.3.2015, ka vendosur pranimin e pjesës së padisë, duke detyruar të paditurin, DRKM-në, Durrës, që t’i paguajë kërkuesit dëmshpërblim 12 paga mujore për lirimin nga Policia e Shtetit në mënyrë të padrejtë, si

dhe shpërblimin e menjëhershëm dhe pagesën kalimtare sipas nenit 12 të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 10142/2009*), si dhe ka rrëzuar si të pabazuara në ligj kërkimet e tjera të padisë. Gjykata ka arsyetuar se kërkuesi me padinë e tij, në thelb, ka kërkuar realizimin e të drejtave që burojnë nga marrëdhënia e punës në Policinë e Shtetit, të cënua nga aktet e kundërshtuara, për rrjedhojë marrëdhënia juridike dhe pasojat e zgjidhjes së saj rregullohen nga Kodi i Punës dhe nga legjislacioni në fuqi për Policinë e Shtetit. Në këtë kuptim, veprimet e kryera nga pala e paditur janë në kundërshtim me ligjin, pasi lirimi i kërkuesit nga Policia e Shtetit është bërë jashtë rasteve të parashikuara nga neni 57 i ligjit nr. 9749/2007, i cili nuk parashikon si shkak për lirimin nga policia ripranimin në polici të një punonjësi të liru për braktisje detyre. Lirimi i kërkuesit nga policia në rastin konkret është në fakt largim nga policia. Për rrjedhojë, kërkuesi duhet të dëmshpërblehet me 12 paga për lirimin nga Policia e Shtetit në mënyrë të padrejtë, si dhe t’i njihet e drejta për trajtimin financiar pas ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, konkretisht e shpërblimit të menjëhershëm dhe pagesës kalimtare sipas nenit 12 të ligjit nr. 10142/2009 (*shih paragrafët 28.2., 28.3., 28.7.1. dhe 28.7.2. të vendimit nr. 249, datë 26.3.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër*).

4. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, në datën 8.4.2015, ka ushtruar ankim vetëm i padituri në proces, DPPSH-ja, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 52, datë 20.1.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin pjesërisht të padisë, duke disponuar për: i. shfuqizimin e urdhrit nr. 219/1/2014 të drejtorit të DPPSH-së, lënë në fuqi me vendimin nr. 451/2014 të Komisionit të Apelit; ii. detyrimin e palës së paditur, DPPSH-së, për të dëmshpërblyer kërkuesin me 12 paga mujore për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës së punës, si dhe për ta trajtuar atë me shpërblim të menjëhershëm dhe



pagesë kalimtare, sipas nenit 12 të ligjit nr. 10142/2009; *iii*. rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj. Sikundër gjykata e shkallës së parë, edhe sipas gjykatës së apelit urdhri i drejtorit të DPPSH-së, lënë në fuqi me vendimin e Komisionit të Apelit të DPPSH-së, është akt i nxjerrë në kundërshtim me nenin 57, pika 2, të ligjit nr. 9749/2007, pasi nuk provohet që kërkuesi të jetë në një prej rasteve të përcaktuara në mënyrë shteruese në atë dispozitë. Ajo gjykatë, në drejtim të rregullimit të pasojave, duke pasur në vëmendje rrethanat konkrete të çështjes, kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës dhe efektin negativ të shkaktuar ndaj kërkuetit, ka çmuar që DPPSH-ja duhet të dëmshpërblejë kërkuetin me 1 vit pagë për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës pa një shkak të mbështetur në ligj, si dhe trajtimin financiar të tij sipas ligjit nr. 10142/2009 (*shih paragrafët 2 dhe 4 të faqes 8, paragrafin 8 të faqes 9, paragrafin 6 të faqes 10, si dhe paragrafin 2 të faqes 11 të vendimit nr. 52, datë 20.1.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit*).

5. Kundër vendimit të gjykatës së apelit, në datën 19.2.2016, DPPSH-ja ka ushtruar rekurs, duke kërkuar ndryshimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit, si dhe rrëzimin e padisë. Në datën 5.5.2016 Gjykata e Lartë ka regjistruar çështjen administrative bazuar në rekursin e DPPSH-së.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-4482 (385), datë 15.11.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. 52, datë 20.1.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të vendimit nr. 249, datë 26.3.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, si dhe rrëzimin e padisë*”, duke arsyetuar se qëndrimet e mbajtura nga gjykata e apelit dhe gjykata e shkallës së parë janë në një linjë të gabuar arsyetimi që nuk përputhen me parashikimet e ligjit material dhe procedural. Sipas Gjykatës së Lartë, për sa i përket urdhrit të përjashtimit të kërkuetit nga Policia e Shtetit në vitin 1999, nuk rezulton ndonjë akt për revokimin/shfuqizimin e tij nga organi publik që e ka nxjerrë ose një vendim gjyqësor që të ketë verifikuar në themel ligjshmërinë e atij akti. Po kështu, as gjykatat e faktit nuk rezulton të kenë vlerësuar nga pikëpamja e ligjshmërisë urdhrin për ripranimin e kërkuetit në Policinë e Shtetit në vitin 2001, duke konstatuar që ky akt është absolutisht i pavlefshëm (*shih paragrafët 20 dhe 23 të vendimit nr. 00-*

2022-4482 (385), datë 15.11.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

7. Me kërkesën e datës 27.2.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-4482 (385), datë 15.11.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Kolegji i Gjykatës në datën 9.5.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar:

8.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, në aspektet e:

8.1.1. *Së drejtës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u dëgjuar*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar dispozitat që lidhen me njoftimin e palëve. Nga sekretaria gjyqësore nuk është kryer asnjë njoftim sipas nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Ajo gjykatë e ka shqyrtuar çështjen pas më shumë se 6 vjetësh, duke marrë parasysh vetëm shkaqet e rekursit, por pa i dhënë atij mundësinë për t’u mbrojtur dhe dëgjuar, si dhe për të paraqitur pretendime e prapësime për çështjen, për më tepër, në rrethanat që vendimi i gjykatës së apelit ishte ekzekutuar.

8.1.2. *Së drejtës për shqyrtimin të çështjes brenda një afati të arsyeshëm*, pasi rekursi i paraqitur nga subjekti i interesuar, DPPSH-ja, është regjistruar në datën 5.5.2016, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar atë në datën 15.11.2022, pra pas më shumë se 6 vjetësh, duke tejkaluar afatin 90-ditor të parashikuar në nenin 60, pika 2, të ligjit nr. 49/2012.

8.1.3. *Së drejtës së barazisë përpara ligjit*, pasi i njëjti trup gjykues i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në të njëjtën datë që ka shqyrtuar çështjen e kërkuetit, ka shqyrtuar edhe një çështje tjetër administrative të ngjashme që i përket një tjetër punonjësi policie të liruar nga detyra, në të cilën, me vendimin nr. 00-2022 (383), datë 15.11.2022, ka



shprehur qëndrim tërësisht të ndryshëm, duke i njohur paditësit të drejtën e dëmshpërblimit për zgjidhje të pajustificuar të marrëdhënies së punës, si dhe vijimin e trajtimit financiar me pagesë kalimtare sipas ligjit nr. 10142/2009.

8.2. *Të drejtën e rehabilitimit dhe/ose të zhdëmtimit*, pasi përgjegjësia për ripranimin në Policinë e Shtetit në vitin 2001 i përket subjektit të interesuar, DPPSH-së, i cili për këtë shkak, ndonëse ka vepruar në shkellje të ligjit, nuk mund të çlirohet nga përgjegjësia për pasojat e shkaktuara nga ndërprerja e marrëdhënies së punës sipas urdhrit nr. 219/1/2014, përmes të cilit ka synuar zbatimin e ligjit. Që nga viti 2001 puna e tij në strukturat e policisë ka vijuar normalisht dhe nuk ka pasur asnjë masë disiplinore, duke krijuar sigurinë se ripranimi në ato struktura ishte kryer në respektim të qëllimit të ligjit, ndërsa kjo marrëdhënie pune mund të vijonte pa një afat të përcaktuar. Për këtë shkak, DPPSH-ja mbart përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit si rrjedhojë e ndërprerjes së menjëhershme të marrëdhënies së punës, pasi ka cenuar edhe *sigurinë juridike* në raport me atë marrëdhënie, qëndrim i shprehur edhe nga njëri anëtar i trupit gjykues të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili në vendimin e kundërshtuar ka dalë me mendim pakice.

9. **Subjekti i interesuar, DPPSH-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

9.1. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u dëgjuar, me argumentin se Gjykata e Lartë nuk ka kryer asnjë njoftim sipas nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, kërkuesi nuk legjitimohet, pasi këtë pretendim e ka ngritur rishtazi në kërkesën drejtuar Gjykatës, pa ia drejtuar atë më parë Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion. Po kështu, për shkak të mënyrës së njoftimit me shpallje të parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile (KPC) dhe ligji nr. 49/2012 për procesin në Gjykatën e Lartë, kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë se si kjo mënyrë e njoftimit të palëve ka sjellë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Po kështu, kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë pretendimet e tij në nivel kushtetues, por është përqendruar në mënyrën se si është realizuar njoftimi i palëve nga Gjykata e Lartë. Kërkuesi nuk ka sjellë argumente në nivel kushtetues për papajtueshmërinë me Kushtetutën të parashikimit ligjor për kryerjen e njoftimit me

shpallje. Ky pretendim është, gjithashtu, i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë e ka publikuar çështjen në shpalljen e datës 25.10.2021, ku ka njoftuar datën dhe orën për zhvillimin e seancës në dhomën e këshillimit, ndërsa në vendimin e Kolegjit Administrativ është shprehur se palët kanë marrë dijeni rregullisht sipas ligjit nëpërmjet shpalljes.

10. **Subjekti i interesuar, DRKM-ja, Durrës**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuessit

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Gjykata vëren se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

13. Në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ankuesi duhet të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi



(shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 56, datë 25.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese).

14. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Nga shqyrtimi i akteve të administruara në funksion të këtij gjykimi kushtetues, Gjykata konstaton se kërkuesi e ka ngritur këtë pretendim përpara Gjykatës, duke mos shteruar paraprakisht mjetet juridike efektive që ka pasur në dispozicion sipas neneve 399/1–399/12 të KPC-së. Vazhdimisht, Gjykata ka theksuar se, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit (shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 3, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për këtë pretendim, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive që ka pasur në dispozicion.

15. Gjykata konstaton se subjekti i interesuar, DPPSH-ja, për sa i përket pretendimit të kërkuesit se Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u dëgjuar, ka prapësuar se nuk legjitimohet, pasi e ka ngritur atë rishtazi përpara kësaj Gjykate, pa ia drejtuar më parë Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

16. Gjykata vëren se për këtë pretendim dhe për pretendimet e tjera për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës së rehabilitimit dhe/ose të zhdëmtimit, si dhe së drejtës së barazisë përpara ligjit, kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

17. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi i fundit i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 15.11.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 27.2.2023, pra brenda afatit 4-mujor.

18. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e

së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u dëgjuar, si dhe cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe të së drejtës së rehabilitimit, të garantuara respektivisht nga nenet 42, 18 dhe 44 të Kushtetutës.

19. Lidhur me cenimin e parimit të barazisë para ligjit, kërkuesi ka pretenduar se në të njëjtën datë, i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Lartë ka zgjidhur në mënyra të ndryshme dy çështje të njëjta. Konkretisht, sipas tij, në çështjen tjetër, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2022 (383), datë 15.11.2022, i ka njohur paditësit të drejtën e dëmshpërblimit, ndërsa në çështjen e tij, ajo ia ka mohuar këtë të drejtë. Gjykata nga krahasimi i dy vendimeve konstaton se ato janë të së njëjtës datë, të dhëna nga i njëjti trup gjykues dhe kanë të bëjnë me mosmarrëveshje të lindura nga ndërprerja e kontratës së shërbimit në Policinë e Shtetit përmes urdhrave përkatës të lirim. Megjithatë, në themel të tyre situata faktike dhe ligjore paraqitet tërësisht e ndryshme, ndryshim që vërehet si në kërkimet e objekteve të padive respektive, ashtu dhe në përfundimet e arritura nga Gjykata e Lartë në ato çështje. Në çështjen e kërkuesit, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se ndërprerja e kontratës së shërbimit të kërkuesit në Policinë e Shtetit ishte e ligjshme për shkak të pavlefshmërisë së urdhrat të ripranimit të tij në polici, ndërsa në çështjen tjetër, ku referon kërkuesi, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin e paligjshmërisë së lirim nga Policia e Shtetit të atij punonjësi, për shkak të ndryshimit të strukturës organizative të Policisë së Shtetit dhe pamundësisë së organit publik për ta sistemuar atë në një detyrë tjetër, bazë mbi të cilën atij i është njohur e drejta e dëmshpërblimit nga fakti i paligjshëm. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë para ligjit është haptazi i pabazuar, pasi, siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta (shih vendimet nr. 20, datë 21.4.2021; nr. 34, datë 10.4.2017; nr. 10, datë 29.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese).

20. Lidhur me pretendimin e cenimit të së drejtës së zhdëmtimit, Gjykata vlerëson se argumentet e kërkuesit nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur



këtë pretendim, në kushtet kur neni 44 i Kushtetutës e lidh këtë të drejtë me dëmtimin nga një akt, veprim ose mosveprim i paligjshëm i organeve shtetërore. Ashtu siç ka arsyetuar Gjykata e Lartë, ripranimi i tij në Policinë e Shtetit ka qenë në kundërshtim me ligjin dhe, për rrjedhojë, akti administrativ që e ka kryer këtë ripranim është absolutisht i pavlefshëm. Për rrjedhojë, ndërprerja në vijim e marrëdhënieve të punësimit, marrëdhënie që bazohej në një akt të paligjshëm, nuk mund të cilësohet në vetvete si akt, veprim ose mosveprim i paligjshëm i organeve shtetërore. Po ashtu, Gjykata thekson se ndonëse vendimi i gjykatës së apelit është ekzekutuar dhe ka kaluar një kohë e gjatë deri në shqyrtimin e rekursit, përderisa i padituri ka paraqitur rekurs, i cili edhe i është njoftuar kërkuesit, nuk ka as cenim të parimit të sigurisë juridike. Ndonëse Gjykata e Lartë nuk e ka evidentuar në vendimin e saj nëse vendimi i gjykatës së apelit ishte ekzekutuar ose jo, me qëllimin për të theksuar pasojat që vijnë për shkak të këtij ekzekutimi të kryer tashmë, (ndërkohë që prej gjashtë vjetësh pritej shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë), gjë që mund ta vendosë kërkuesin në vështirësi ekonomike, duke u ndodhur para detyrimit për kthimin e dëmshpërblimit, Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka bërë asnjë përpjekje në këtë drejtim, në kuptimin e paraqitjes së kundërrkursit ose paraqitjes së parashtrimeve dhe dokumentacionit me rëndësi për çështjen e tij. Në këto rrethana, Gjykata çmon se edhe ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar dhe nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës së procesit të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u dëgjuar, hyn në juridiksionin kushtetues dhe do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor të lidhur me të drejtën për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u dëgjuar

22. Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt referuar procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë në aspektin e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u dëgjuar, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar dispozitat që lidhen me njoftimin e palëve. Nga sekretaria gjyqësore nuk është kryer asnjë njoftim sipas nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Ajo gjykatë e ka shqyrtuar çështjen

pas më shumë se 6 vjetësh, duke marrë parasysh vetëm shkaqet e rekursit, por pa i dhënë atij mundësinë për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, si dhe për të paraqitur pretendime e prapësime për çështjen, për më tepër, në rrethanat që vendimi i gjykatës së apelit ishte ekzekutuar.

23. Gjykata, fillimisht, thekson standardin kushtetues të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës që parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë.

24. Për garantimin e një gjykimi të drejtë, Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerëve. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 49, datë 22.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Secila palë duhet të ketë mundësi të komentojë për të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës (*shih vendimet nr. 73, datë 14.12.2015; nr. 4, datë 23.2.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjithashtu, Gjykata është shprehur se është detyrë e administratës gjyqësore të marrë masat për të kryer njoftimin e palëve ndërgjyqëse, duke theksuar se, gjithashtu, është detyrë edhe e palëve që të ndjekin ecurinë e gjykimit të çështjes së tyre në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 47, datë 6.7.2015; nr. 32, datë 22.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).



26. Gjykata evidenton se sipas nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 (ndryshuar me ligjin nr. 49/2021, datë 23.3.2021), gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 15 ditë përpara. Po kështu, neni 482, pika 3, i KPC-së, i zbatueshëm për gjykimin administrativ, parashikon se njoftimi me shpallje bëhet edhe në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë. Krahas njoftimit me shpallje, kjo dispozitë parashikon edhe njoftimin individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimin. Këto rregulla janë detajuar në urdhrin nr. 131, datë 2.7.2021, “Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve” të nxjerrë nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë.

27. Nga aktet e dosjes gjyqësore, Gjykata vëren se DPPSH-ja në datën 19.2.2016 ka paraqitur rekurs drejtuar Gjykatës së Lartë për të kundërshtuar vendimet e dy gjykatave më të ulëta, i cili i është njoftuar kërkuarit në datën 8.3.2016 përmes dëftesës së komunikimit nr. 1625/535 regj., datë 7.3.2016, të marrë në dorëzim nga një familjarë e afërt e tij. Gjykata e Lartë në datën 28.10.2022 ka publikuar në faqen zyrtare dhe në ambientet e saj listën e çështjeve të planifikuara për shqyrtim në dhomën e këshillimit nga Kolegji Administrativ në datën 15.11.2022, mes të cilave edhe çështjen e kërkuarit, domethënë 18 ditë përpara datës së shqyrtimit. Ky Kolegj, me vendimin nr. 00-2022-4482 (385), datë 15.11.2022, ka disponuar, duke ndryshuar vendimet e dy gjykatave më të ulëta dhe rrëzuar padinë, vendim të cilin e ka publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës. Pra, kërkuari ka pasur dijeni për procesin dhe për të drejtat e tij procedurale. Gjykata e Lartë ka evidentuar në vendim faktin se rekursi i është komunikuar kërkuarit, i cili nuk ka paraqitur kundërrekurs. Ajo gjykatë, referuar ecurisë së marrëdhënies së shërbimit të kërkuarit në Policinë e Shtetit, ka vlerësuar se shkaqet e rënda për të cilat është vendosur përjashtimi i një punonjësi nga Policia e Shtetit nuk mund të tejkalohen përmes një urdhri të dytë për rripranim në detyrë, për sa kohë nuk ka një akt revokimi/shfuqizimi të aktit administrativ të përjashtimit nga detyra nga vetë organi publik ose një vendim gjyqësor që të ketë

verifikuar në themel ligjshmërinë e aktit të përjashtimit.

28. Për sa më sipër, Gjykata çmon se ky pretendim është i pabazuar, pasi ndryshe nga sa ka pretenduar kërkuari, Gjykata e Lartë ka respektuar dispozitat e parashikuara në ligj për sa i përket njoftimit të palëve, ndërsa nuk argumentohet nga kërkuari, por edhe nuk evidentohet nga aktet e procesit, që atij t'i jetë shkelur ndonjë e drejtë procedurale si palë ndërgjyqëse në proces, përfshirë edhe ajo për t'u mbrojtur dhe dëgjuar. Çështja është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, formë gjykimi sipas së cilës ajo e shqyrton çështjen në bazë të pretendimeve dhe shkaqeve të ngritura në rekurs, si dhe të prapësimeve të paraqitura në kundërrekurs (neni 482, pika 5, i KPC-së), ndërkohë që në rastin në shqyrtim kërkuari ka zgjedhur të mos ushtrojë të drejtën e kundërrekursit (neni 477 i KPC-së), duke zgjedhur kështu ai vetë atë mënyrë mbrojtjeje të interesave të tij në gjykim.

29. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor të lidhur me të drejtën për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u dëgjuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, është i pabazuar, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 e 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 7.11.2023.

Shpallur më 7.12.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Sandër Beci, Genti Ibrahim



VENDIM
Nr. 55, datë 7.11.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 7.11.2023
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 4 (E) 2023 të Regjistrit
Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Esat Çoji

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Trans-
portit Rrugor; Drejtorja Rajonale e Shërbimeve të
Transportit Rrugor Elbasan

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-
2649, datë 3.11.2022, të Kolegjit Administrativ të
Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën
e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Kolegjin
Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika
1, 33, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1,
shkronja “F”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142, pika
1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
(*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane
për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe Protokolli nr.
1 i saj; neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për
organizimin dhe funksionimin e Gjykatës
Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të
ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në
shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili
ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me
shkrim të subjekteve të interesuara, Drejtorisë së
Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor

(*DPSHTRR*) dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve
të Transportit Rrugor (*DRSHTRR*), Elbasan, të cilat
kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi
çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me urdhrin e datës 31.7.2006 të drejtorit të
Përgjithshëm të *DPSHTRR*-së, kërkuari Esat Çoji
është emëruar inspektor në Sektorin e Kontrollit të
Transportit Rrugor pranë *DRSHTRR*-së, Elbasan.
Marrëdhëniet e punës mes palëve janë formalizuar
me kontratën e punës të datës 18.11.2009, me
kohëzgjatje të pacaktuar.

2. Në datën 21.11.2013, bazuar në nenin 144 të
Kodit të Punës, kërkuari është njoftuar nga
punëdhënësi për t’u paraqitur në datën 26.11.2013,
për të filluar bisedimet për ndërprerjen e
marrëdhënieve të punës. Pas takimit të zhvilluar mes
palëve në këtë datë, kërkuarit i është komunikuar
vendimi i *DPSHTRR*-së nr. 188, datë 2.12.2013, për
ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të
riorganizimit të drejtorisë, me qëllim rritjen e
performancës së institucionit (*vendimi nr. 188/2013*).
Sipas këtij vendimi, marrëdhëniet financiare të
kërkuarit do të ndërpriteshin në datën 3.3.2014,
ndërsa periudha 2.12.2013–3.3.2014 përbënte afatin
e njoftimit sipas nenit 143 të Kodit të Punës. Po me
këtë vendim, kërkuarit i është njohur e drejta e
përfitimit të shpërblimit për vjetërsi në punë sipas
nenit 145 të këtij kodi, si dhe e drejta e përfitimit të
pagave për lejet vjetore të pakryera për vitet 2013
dhe 2014.

3. Pas vendimit nr. 188/2013, kërkuarit i është
dhënë leja vjetore takuese për vitin 2014 (4 ditë), për
periudhën 26.2.2014–3.3.2014, dhe në momentin e
ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, i është paguar
edhe shpërblimi për vjetërsi në punë, i llogaritur mbi
pagën bruto mujore prej 56.000 lekësh.

4. Në datën 17.4.2014 kërkuari ka paraqitur
kërkesëpadi kundrejt *DPSHTRR*-së dhe
DRSHTRR-së, Elbasan, me objekt kthimin në
vendin e mëparshëm të punës, në pozicionin e
inspektorit, si pasojë e pavlefshmërisë së zgjidhjes së
marrëdhënieve të punës sipas vendimit nr.
188/2013, si dhe pagimin e pagës për kohën e



qëndrimit pa punë padrejtësisht deri në ekzekutimin e vendimit të gjykatës.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 690, datë 22.5.2014, ka rrëzuar padinë si të pabazuar në ligj dhe prova. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

6. Gjykata Administrative e Apelit, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 676, datë 25.3.2016, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka pranuar pjesërisht padinë, duke vendosur detyrimin e të paditurit, DPSHTRR-së, të dëmshpërblejë paditësin (kërkuesin) me 12 paga mujore për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës (sipas nenit 155, pika 3, të Kodit të Punës), si dhe me pagesën që i korrespondon periudhës së pushimeve vjetore të kryera brenda periudhës 2.12.2013–3.3.2014, ndërsa ka rrëzuar padinë për kërkimet e tjera. Kundër këtij vendimi të paditurit në proces kanë ushtruar rekurs.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-2649, datë 3.11.2022, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

8. Në datën 23.2.2023 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim po në atë gjykatë. Në datën 11.5.2023 Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31 të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 17.5.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se Gjykata e Lartë i ka cenuar:

9.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1.1. *Parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur*, pasi ajo gjykatë ka vënë në diskutim kryesisht çështjen e ligjit të zbatueshëm, për të cilën pala e paditur nuk ka pasur ndonjë pretendim gjatë procesit gjyqësor, por edhe në rekursin e paraqitur, duke kërkuar që mosmarrëveshja të zgjidhej sipas

dispozitave të Kodit të Punës, ndërkohë që kërkuesi nuk ka paraqitur rekurs, duke u pajtuar me vendimin e gjykatës së apelit. Gjykata e Lartë ka vënë në diskutim, kryesisht, edhe çështjen e kufijve të shqyrtimit nga gjykata e apelit, e cila nuk është ngritur në rekurs. Duke vënë në diskutim çështje që nuk janë ngritur në rekursin e palës së paditur, të cilat kanë rënë në dekadencë, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë mundësinë kërkuesit të mbrohej, duke paraqitur parashtrimet e tij për këto çështje të ligjit përpara seancës së shqyrtimit të rekursit, sikurse kërkon neni 473/a i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

9.1.2. *Parimit të sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar*, pasi ajo gjykatë ka marrë në shqyrtim çështjen në një kohë kur vendimi i formës së prerë i gjykatës së apelit ishte ekzekutuar. Duke vepruar në këtë mënyrë, ajo nuk ka mbajtur në konsideratë praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ lidhur me heqjet dorë nga rekursitet dhe mospranimin e tyre kur ato janë ushtruar nga institucionet shtetërore, në cilësinë e palëve të paditura, referuar udhëzimit nr. 1, datë 26.5.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për heqjen dorë nga rekursitet e depozituara nga administrata shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, të pashqyrtuara nga Gjykata e Lartë, për disa çështje me natyrë civile dhe administrative” (*udhëzimi nr. 1/2022*).

9.1.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi kërkuesit nuk i është krijuar mundësia të dëgjohej për çështjet e vëna në diskutim kryesisht, të cilat nuk ishin ngritur në rekursin e palës së paditur. Gjykata e Lartë, në kundërshtim me nenet 58 dhe 63, shkronjat “a” dhe “dh”, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), nuk e ka shqyrtuar çështjen mbi bazën e shkaqeve të rekursit, por i ka tejkaluar ato.

9.1.4. *Standardit të arsyetimit*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka në përmbajtje një analizë juridiko-ligjore dhe i mungon tërësisht arsyetimi, si dhe është kontradiktor. Në vendim pranohet se gjykata administrative ka detyrimin të verifikojë ligjin që rregullon marrëdhënien e punës, por jo rregullimin e pasojave nga mosrespektimi i zgjidhjes së kësaj marrëdhënieje, çka bie në kundërshtim edhe me nenin 17, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, si dhe me praktikën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.



9.2. *Parimin e barazisë përpara ligjit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi kërkuesi gjendet në kushte pabarazie me shtetasit e tjerë, për të cilët është vendosur mospranimi i rekursit sipas udhëzimit nr. 1/2022, duke u penalizuar në këtë mënyrë nga mosveprimi i subjekteve të interesuara, të cilat janë sjellë në mënyrë indiferente dhe me standard të dyfishtë, ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur qëndrim ndaj tyre, duke i favorizuar ato.

9.3. *Të drejtën e pronës private*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi mohimi i ekzekutimit të vendimit të formës së prerë i ka sjellë mohimin e vlerave financiare të pagës që duhej të përfitonte për shkak të largimit të padrejtë nga detyra.

10. **Subjektet e interesuara, DPSHTRR-ja dhe DRSHTRR-ja, Elbasan**, kanë paraqitur të njëjtat argumente dhe, në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar:

10.1. Pretendimi i kërkuesit për *cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtëm të parimit të sigurisë juridike, parimit të barazisë së armëve dhe standardit të arsytimit të vendimit, është i pabazuar. Shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë nuk kushtëzohet nga ekzekutimi ose jo i vendimit të gjykatës së apelit, ndërsa zhvillimi i gjykimit në dhomën e këshillimit është e drejtë e asaj gjykate, në zbatim të nenit 61 të ligjit nr. 49/2012. Po kështu, vendimi i kundërshtuar është logjik, i qartë në përmbajtje dhe përmbush kriteret për arsyetimin e tij, duke mos lënë hapësira për keqinterpretime ose paqartësi. Për më tepër, pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, dhe nuk rezulton që atij t'i jetë cenuar ndonjë e drejtë kushtetuese, ndërsa qëndrimi i Gjykatës së Lartë është në përputhje me tagrat e saj ligjore.

10.2. Kërkuesi nuk gjendet në kushtet e pabarazisë me shtetasit e tjerë për të cilët është vendosur mospranimi i rekursit, për shkak të zbatimit të udhëzimit nr. 1/2022, i cili është një hap procedural i ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë. Për rrjedhojë, nuk është cenuar as *parimi i barazisë përpara ligjit*.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas

neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “P” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, që ka përmbyllur në themel gjykimin e padisë së tij që lidhet me marrëdhëniet e punës, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

14. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 3.11.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 23.2.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar, në drejtëm të së drejtës për proces të rregullt, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur, ashtu edhe në drejtëm të gjësë së gjykuar, cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit dhe të standardit të arsytimit të vendimit, si dhe cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe të së drejtës së pronës private, të



garantuara respektivisht nga nenet 18 dhe 41 të Kushtetutës.

16. Pretendimin për cenimin e parimit të *sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar*, kërkuesi e ka mbështetur në argumentin se Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim një vendim që ishte ekzekutuar tashmë, duke iu referuar vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili në dispozitivin e tij përcaktonte se ishte titull ekzekutiv i ekzekutueshëm nga shërbimi përmbarimor gjyqësor. Mbi të njëjtin argument kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës së pronës private*. Nga ana tjetër, për këtë pretendim, subjektet e interesuara kanë prapësuar se kërkuesi nuk ka shpjeguar në mënyrë të qartë dhe nuk ka provuar se si është cenuar parimi i sigurisë juridike, në kushtet kur shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë nuk kushtëzohet nga ekzekutimi ose jo i vendimit të gjykatës së apelit.

17. Në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Gjykata ka pohuar se siguria juridike nënkupton se kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim (*shih vendimet nr. 10, datë 13.2.2017; nr. 23, datë 8.6.2007, të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar kur zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve në mënyrë përfundimtare (*shih vendimin nr. 12, datë 17.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kontekst, në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, për sa ajo ka disponuar për detyrimin e palës së paditur për pagimin e një shpërblimi në favor të kërkuesit, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe ekzekutimin e tij si titull ekzekutiv nga shërbimi përmbarimor gjyqësor, është i formës së prerë në kuptim të fuqisë ekzekutive (për sa kohë nuk ka një vendim të Gjykatës së Lartë për pezullimin e ekzekutimit të tij). Pavarësisht kësaj, ai nuk përbën një vendim përfundimtar me fuqinë e gjësë së gjykuar (*res judicata*), për sa i përket zgjidhjes në themel të mosmarrëveshjes mes palëve, për sa kohë që palët kanë përdorur mjetet e zakonshme të ankimit (pala e paditur ka paraqitur rekurs), duke e bërë në këtë mënyrë Gjykatën e Lartë kompetente për të shqyrtuar çështjen dhe për të vendosur përfundimisht në lidhje me të. Për rrjedhojë, argumenti i parashtruar nga kërkuesi nuk mund të shërbejë si argument kushtetues në funksion të pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike.

18. Lidhur me pretendimin për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, kërkuesi ka argumentuar se, në ndryshim nga shtetasit e tjerë, të cilët kanë përfituar nga zbatimi i udhëzimit nr. 1/2022, kur institucionet e administratës shtetërore kanë hequr dorë nga rekursat e tyre, në rastin e tij palët e paditura nuk kanë vepruar në të njëjtën mënyrë, duke u sjellë në mënyrë indiferente dhe duke e penalizuar atë. Ato kanë vepruar me standard të dyfishtë në trajtimin e çështjeve të marrëdhënieve të punës në ato raste kur vendimi i rekursuar ishte ekzekutuar prej vitesh dhe në kundërshtim me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ lidhur me heqjet dorë nga rekursat dhe mospranimin e tyre kur ato janë ushtruar nga institucionet shtetërore, referuar atij udhëzimi. Ndërkohë, për këtë pretendim, subjektet e interesuara kanë prapësuar se kërkuesi nuk gjendet në kushtet e pabarazisë me shtetasit e tjerë të cilëve u është vendosur mospranimi i rekursit për shkak të zbatimit të udhëzimit nr. 1/2022, i cili është një hap procedural i ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë.

19. Gjykata vëren se ky pretendim i kërkuesit, në thelb, lidhet me *parimin e disponibilitetit në gjykim*, sipas të cilit gjykata nuk procedon vetë dhe nuk merr në shqyrtim një mosmarrëveshje nëse këtë nuk e kërkon i interesuari. Dispozitat procedurale civile, të cilat janë të aplikueshme edhe për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative (*neni 1, pika 2, i ligjit nr. 49/2012*), parashikojnë se vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveçse kur ligji parashikon ndryshe (*neni 2 i KPC-së*) dhe se gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet (*neni 6 i KPC-së*). Në kontekst të rrethanave të rastit në shqyrtim dhe argumentit të parashtruar nga kërkuesi, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të ushtruar nga pala e paditur, e cila nuk rezulton të ketë shprehur ose paraqitur ndonjë kërkesë për heqjen dorë prej tij.

20. Gjykata vëren se udhëzimi nr. 1/2022 ka përcaktuar rregullat për heqjen dorë nga rekursat e paraqitura përpara hyrjes në fuqi të tij, nga administrata shtetërore, nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, kundër vendimeve të gjykatave të apelit dhe Gjykatës Administrative të Apelit, për çështjet me natyrë civile dhe administrative me objekt të përcaktuar shprehimisht, ndër to edhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin nga



marrëdhëniet e punës, në të cilat administrata shtetërore, nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, shfaqet në cilësinë e punëdhënësit, në rastet kur: i. gjykata e apelit ose Gjkata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka vendosur pranimin e padisë dhe përmbushjen e detyrimit nga institucioni, në vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi (*pika 1, shkronja "a"*); ii. dhe Gjkata e Lartë, deri në momentin e hyrjes në fuqi të udhëzimit, nuk ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë (*pika 5*). Për zbatimin e udhëzimit janë ngarkuar institucionet e administratës shtetërore dhe shoqëritë tregtare me mbi 50% kapital shtetëror, aksionet ose kuotat e të cilave zotërohen nga institucionet e administratës shtetërore, nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave (*pika 7*).

21. Nga sa më lart, në rastin në shqyrtim, përgjegjësia për zbatimin e udhëzimit nr. 1/2022, pra për sa i përket heqjes dorë nga rekursi nëse plotësohen kërkesat e tij, i përket palës së paditur (punëdhënësit). Edhe pse është e paqartë nëse kjo e fundit ka verifikuar zbatueshmërinë e këtij udhëzimi në rastin e kërkuarit, përderisa është fakt që ajo nuk ka hequr dorë nga rekursi në kuptim të dispozitave të mësipërme procedurale, Gjkata e Lartë nuk mund të vlerësonte kryesisht zbatueshmërinë e një akti të tillë nënligjor ose të ndryshonte vullnetin e palës që e ka vënë atë në lëvizje. Në këtë kuptim, në kushtet kur heqja dorë nga rekursi ishte në disponibilitetin e palës së paditur, Gjkata e Lartë nuk mund të vendoste *ultra petita* për mosshqyrtimin (mospranimin) e tij. Për rrjedhojë, Gjkata vlerëson se kërkuari nuk ka arritur të provojë, në aspektin kushtetues, se si qëndrimi i asaj gjykate ka cenuar parimin e barazisë përpara ligjit.

22. Për sa i takon së drejtës për proces të rregullt ligjor, sipas kërkuarit, Gjkata e Lartë i ka shkelur të drejtën për t'u mbrojtur, pasi ajo nuk e ka dëgjuar paraprakisht atë, në rrethanat kur ka shqyrtuar në dhomën e këshillimit, me nismën e saj, çështje të ligjit që nuk ishin ngritur në rekursin e palës së paditur. Po kështu, Gjkata e Lartë ka tejkaluar kufijtë e gjykimit, të përcaktuar në nenet 58 dhe 63, shkronjat "a" dhe "dh", të ligjit nr. 49/2012, sepse nuk e ka gjykuar çështjen mbi bazën e shkaqeve të rekursit, të cilat lidheshin vetëm me zbatimin e dispozitave të Kodit të Punës, duke mos pasur një

analizë juridiko-ligjore dhe në mungesë tërësore të arsytimit në këtë aspekt. Për pasojë, sipas kërkuarit, ajo ka cenuar edhe parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, si dhe standardin e arsytimit. Duke pasur parasysh thelbin e këtyre pretendimeve, Gjkata çmon t'i analizojë ato në këndvështrim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe së drejtës për t'u mbrojtur e dëgjuar, të lidhura me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat, duke qenë me natyrë kushtetuese do të shqyrtohen në vijim për bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe së drejtës për t'u mbrojtur e dëgjuar të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

23. Kërkuari ka pretenduar se Gjkata e Lartë ka tejkaluar kufijtë e gjykimit, të përcaktuar në nenet 58 dhe 63, shkronjat "a" dhe "dh", të ligjit nr. 49/2012, sepse nuk e ka shqyrtuar çështjen mbi bazën e shkaqeve të rekursit të palës së paditur, i cili nuk përmbante asnjë shkak ligjor për cenimin e vendimit të gjykatës së apelit. Gjkata e Lartë ka vënë në diskutim, kryesisht, çështjen e ligjit të zbatueshëm, për të cilën pala e paditur nuk ka pasur ndonjë pretendim as gjatë procesit gjyqësor, si dhe çështjen e kufijve të shqyrtimit nga gjykata e apelit, e cila, gjithashtu, nuk është ngritur në rekurs. Duke vënë në diskutim çështje që nuk janë ngritur në rekurs dhe që, për këtë shkak, kanë rënë në dekadencë, Gjkata e Lartë nuk i ka dhënë mundësinë kërkuarit të mbrohej duke paraqitur parashtrimet e tij për këto çështje përpara seancës së shqyrtimit të rekursit, sikurse kërkon neni 473/a i KPC-së. Për më tepër, interpretimi i bërë nga Gjkata e Lartë për këto çështje bie ndesh me nenin 17, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, por edhe me praktikën gjyqësore sipas vendimit unifikues nr. 3/2012, për sa i përket shkakut të padisë dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i saj dhe së drejtës që paditësi kërkon të mbrojë përmes padisë.

24. Po kështu, sipas kërkuarit, vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor. Ajo shprehet se Kodi i Punës ka parashikuar qartë dhe konkretisht se cilat janë pasojat konkrete që mund të kërkojnë me padi në gjykatë në rastin e zgjidhjes pa shkaqe të arsyeshme ose në mënyrë të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës dhe, mbi këtë bazë paditësi punëmarrës duhet të identifikojë në



padi pasojat e kërkuara nga zgjidhja e kontratës. Më tej, ajo shprehet se është detyrë funksionale e gjykatës administrative të identifikojë saktë ligjin që rregullon marrëdhënien e punësimit në administratën publike dhe të përcaktojë se mosmarrëveshja e lindur rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës në raport me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, por shpërblimi i përcaktuar sipas neneve 141, 143, 144, 145 153 e në vijim të Kodit të Punës duhet të njihet vetëm mbi kërkimin e punëmarrësit. Pra, Gjykata e Lartë pranon se gjykata administrative ka detyrimin të verifikojë ligjin që rregullon marrëdhënien e punësimit, por jo zgjidhjen e pasojave nga mosrespektimi i zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, çka, për më tepër, bie në kundërshtim me nenin 17, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 dhe jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

25. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se vendimi i Gjykatës së Lartë është i drejtë dhe i bazuar dhe se nuk evidentohet shkelja e ndonjë prej elementeve të së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të sigurisë juridike, kontradiktoritetit dhe standardit të arsyetimit. Sipas tyre, kërkuar nuk ka shpjeguar në mënyrë të qartë dhe nuk ka provuar se ku është cenuar parimi i sigurisë juridike, ndërsa zhvillimi i gjykimit në dhomën e këshillimit është e drejtë e asaj gjykate, në zbatim të nenit 61 të ligjit nr. 49/2012. Po kështu, vendimi i kundërshtuar është logjik, i qartë në përmbajtje dhe përmbush kriteret për arsyetimin e tij, duke mos lënë hapësira për keqinterpretime ose paqartësi. Pretendimet e kërkuar kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit dhe qëndrimi i Gjykatës së Lartë është në përputhje me tagrat e saj ligjore.

26. E drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, në sensin material karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjrisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe

që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 22, datë 22.7.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. E drejta e mbrojtjes dhe ajo për t’u dëgjuar, si elemente, gjithashtu të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në unitet edhe me të drejta të tjera, kanë për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor, ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t’u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 18, datë 4.4.2023; nr. 7, datë 12.3.2010; nr. 12, datë 6.6.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata ka vënë dukje se kur Gjykata e Lartë merr në shqyrtim çështje ligjore që nuk janë paraqitur si shkaqe në rekurs, duke i verifikuar ato me nismën e saj, ajo duhet që paraprakisht t’u japë mundësi palëve ndërgjyqëse të paraqesin mendimet e tyre, me qëllim garantimin e së drejtës për t’u mbrojtur efektivisht lidhur me to dhe disponimin e një vendimi gjyqësor, që u jep përgjigje përfundimtare pretendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2023; nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 40, datë 22.12.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Nga ana tjetër, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 31, datë 29.5.2023; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i standardit të arsyetimit është vlerësuar nga Gjykata,



rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 50, datë 18.10.2023; nr. 3, datë 23.1.2014; nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë standardet e mësipërme kushtetuese në raport me rrethanat dhe faktet e çështjes në shqyrtim, vëren se kërkuesi ka paraqitur padi në gjykatën administrative të shkallës së parë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë padrejtësisht deri në ekzekutimin e vendimit të gjykatës, si të drejta që rrjedhin nga statusi i nëpunësit civil, në bazë të ligjit nr. 152/2013. Gjykata e shkallës së parë ka rrëzuar padinë si të pabazuar në prova dhe në ligj, duke vlerësuar se marrëdhënia juridike mes palëve është një marrëdhënie pune e zakonshme, e cila ka përfunduar me zgjidhjen e njëanshme të kontratës së punës nga punëdhënësi, pas përfundimit të afatit të njoftimit. Referuar edhe vendimit unifikues nr. 19/2007 të Gjykatës së Lartë, respektimi nga punëdhënësi i kërkesave të neneve 141, 143, 144 dhe 145 të Kodit të Punës, si rregull, passjell përfundimin në mënyrë të natyrshme të kontratës së punës. Nga ana tjetër, gjykata e ka gjetur të pabazuar pretendimin e kërkuetit se marrëdhënia e tij e punësimit është marrëdhënie shërbimi civil, duke arsyetuar se referuar nenit 2 të ligjit nr. 152/2013 dhe aktit nënligjor të nxjerrë në zbatim të tij, vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, DPSHTRR-ja nuk përfshihet në asnjë nga institucionet e administratës publike, punonjësit e të cilave përfitojnë statusin e nëpunësit civil dhe marrëdhëniet e punësimit të tyre të konsiderohen si marrëdhënie shërbimi civil për shkak të ligjit nr. 152/2013. Nisur nga kjo, mosmarrëveshja e lindur ndërmjet palëve, për shkak të ndërprerjes së kontratës së punës, nuk mund të zgjidhet duke paraqitur si shkak ligjor ligjin nr. 152/2013. Po kështu, gjykata ka arsyetuar se padia e kërkuetit ishte e pabazuar edhe referuar dispozitave të Kodit të

Punës, i cili nuk parashikon rikthimin në punë si një e drejtë e punëmarrësit që mund të rivendoset me anë të padisë gjyqësore.

30. Kërkuesi e ka kundërshtuar me ankim vendimin e gjykatës së shkallës së parë, me pretendimin se ajo ka zbatuar gabim ligjin material, duke kërkuar që mosmarrëveshja të zgjidhej sipas ligjit nr. 152/2013.

31. Mbi këtë ankim, gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka pranuar pjesërisht padinë, duke vendosur detyrimin e të paditurit, DPSHTRR-së, të dëmshpërblejë kërkuetin me 12 paga mujore për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës sipas nenit 155, pika 3, të Kodit të Punës, si dhe me pagesën e periudhës së pushimeve vjetore të vitit 2014, ndërsa ka rrëzuar padinë për kërkimet e tjera. Gjykata e apelit ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë edhe pse i ka cilësuar saktë faktet dhe veprimet e lidhura me mosmarrëveshjen, nuk ka identifikuar dispozitat e detyrueshme për t’u zbatuar prej saj në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes, në kuptim të nenit 17, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, Sipas saj, analiza e pretendimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse lidhur me konfliktin mes tyre duhej t’u përmbahej kufijve të shqyrtimit gjyqësor, të përcaktuar në nenin 37, pika 1, të këtij ligji.

32. Gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se kërkuesi nuk ka fituar statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, i cili nuk është i zbatueshëm në rastin konkret dhe se marrëdhëniet e punës mes palëve rregullohen nga Kodi i Punës, çka nuk përligjte ankimin e kërkuetit për pavlefshmërinë e aktit të largimit nga puna dhe zgjidhjen e pasojave të këtij akti përmes rikthimit në detyrën e mëparshme dhe pagimin e pagës deri në rikthim, referuar edhe vendimit unifikues nr. 7/2011 të Gjykatës së Lartë. Megjithatë, ajo ka vërejtur se sipas vendimit nr. 190/2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, pavarësisht mënyrës së formulimeve të kërtimeve në padi dhe në aktet e tjera të procesit “kundërshtim akti administrativ”, “detyrim për rikthim në punë” etj., këto kërtime kanë lidhje me pretendime që burojnë nga marrëdhënia e punës dhe në këto kushte është detyrë e gjykatës të hetojë në lidhje me to dhe të zgjidhë pasojat përkatëse. Mbi këtë bazë, gjykata e apelit është shprehur se mban në vëmendje se, pavarësisht mënyrës së ndërtimit të mbrojtjes nga kërkuesi, konkretizuar në kërkimet pjesë e objektit të padisë, ajo do t’i referohet, në



rastin konkret, zbatimit të dispozitave të Kodit të Punës, me qëllim që, mbi bazën e tyre të zgjidhë konfliktin mes palëve ndërgjyqëse. Ajo gjykatë ka argumentuar se mosrespektimi i afatit të zgjidhjes së kontratës së punës, në kushtet e ekzistencës së një kontrate pune pa afat të caktuar dhe të një shkaku që nuk justifikon zgjidhjen e menjëhershme të saj, vlerësohet se përbën rrethanë të mjaftueshme për dëmshpërblimin e paditësit në bazë të nenit 155/3 të Kodit të Punës. Gjithashtu, ajo është shprehur se respektimi i afatit të njoftimit dhe kryerja e lejes së zakonshme përbëjnë dy të drejta për punëmarrësin e rrjedhimisht dy detyrime për punëdhënësin, të cilat, si të tilla, duhen përmbushur në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra. Koha që i korrespondon afatit të njoftimit të zgjidhjes së kontratës së punës nuk mund të shërbejë njëherësh si periudhë kohe gjatë së cilës punëmarrësi duhet të kryejë edhe lejen e zakonshme.

33. Kundër vendimit të gjykatës së apelit, për pjesën e pranuar të padisë, pala e paditur në proces ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, duke pretenduar se ai është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material, pasi në zgjidhjen e marrëdhënies së punës janë respektuar dispozitat e Kodit të Punës lidhur me afatet e njoftimit dhe procedurën dhe se ndërprerja e tyre nuk është bërë në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar, por në përfundim të afatit të njoftimit.

34. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, me të cilin padia e kërkuarit është rrëzuar në tërësi, duke vlerësuar se rekursi përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, të cilat, nga njëra anë, bënin të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit dhe, nga ana tjetër, çonin në lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, por me arsyetimin e duhur. Kolegji Administrativ e ka gjetur të drejtë e të bazuar në ligj përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se marrëdhënia e punësimit mes palëve nuk ishte marrëdhënie administrative e shërbimit civil dhe se paditësi nuk gëzonte statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, por vetëm mbi këtë premisë vlerësimi nuk mund të rrëzohej padia e tij. Edhe pse gjykata e apelit ka mbajtur të njëjtin qëndrim, ajo ka vijuar gjykimin duke e zgjidhur mosmarrëveshjen bazuar në një shkak tjetër ligjor, të papretenduar nga paditësi (kërkuari), duke u bazuar në dispozitat e

Kodit të Punës, qëndrim ky që shkelte nenet 17, pikat 1, shkronja “c” dhe 2, 35 dhe 37, pika 5, të ligjit nr. 49/2012, si dhe nenet 2, 6, 14, 16, 18, 19 dhe 28 të KPC-së.

35. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka evidentuar se padia është mjeti juridik që gjeneron procesin civil ose administrativ dhe vendos kufijtë e juridiksionit të shqyrtimit gjyqësor, për rrjedhojë gjykatat nuk mund të vendosin *ultra petita* dhe njëkohësisht janë të detyruara të shqyrtojnë, të shprehën dhe të disponojnë për atë që i kërkohet. Nisma për të filluar procesin i takon paditësit, sepse gjykata nuk procedon vetë dhe nuk merr në shqyrtim një mosmarrëveshje nëse këtë nuk e kërkon i interesuari. Mbi këtë bazë, Kolegji Administrativ ka konstatuar se padia e kërkuarit ka si objekt dhe shkak ligjor kërkimin për rikthimin në punën e mëparshme dhe pagimin e pagës deri në momentin e rikthimit në punë, mbi pretendimin se gjatë marrëdhënies së punës ka fituar statusin e nëpunësit civil në bazë të ligjit nr. 152/2013, qëndrim të cilin kërkuari e ka parashtruar edhe në ankim. Sipas këtij Kolegji, gjykata e apelit, pavarësisht se ka konkluduar se kërkuari nuk gëzon statusin e nëpunësit civil dhe se marrëdhënia e punës rregullohet nga Kodi i Punës, ka vendosur kryesisht për pranimin pjesërisht të padisë, pa pasur kërkim nga paditësi (kërkuari) për zbatimin e neneve 143, 144, 153 dhe 155 të atij kodi për njohjen/dhënien e shpërblimeve përkatëse, ndërkohë që ai nuk ka kërkuar në gjykimin në shkallë të parë ndryshimin e shkakut ligjor dhe objektit të padisë sipas nenit 185 të KPC-së, si dhe nuk ka parashtruar në ankim pretendime lidhur me moszbatimin nga ajo gjykatë të njohjes/dhënies së shpërblimeve. Në tilla rrethana, sipas Kolegjit, prezumohet se këto pretendime kanë rënë në dekadencë në bazë të nenit 459 të KPC-së, edhe sikur pretendimi nga paditësi (kërkuari) të jetë ngritur në formën e shpjegimeve gjatë gjykimin në shkallë të parë dhe jo me mjetin e duhur procedural.

36. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit nuk mund të shprehej tej kërkimeve në padi dhe në objektin e ankimit, dhe se duke vepruar *ultra petita partium*, pa pasur autorizim të shprehur ligjor, ajo nuk përmbush më rolin e saj si një arbitër i paanshëm, pasi krijohen premisa për pamundësinë objektive për palën tjetër të realizojë mbrojtje ligjore në gjykim. Gjykata nuk mund të shprehet kryesisht për pasojat e zgjidhjes së



kontratës së punës pa disponimin maksimal dhe ekskluziv në padi, nga ana e paditësit punëmarrës, ndërkohë që referimi i bërë nga gjykata e apelit në vendimin nr. 190/2014 të Gjykatës së Lartë dhe vendimit unifikues nr. 7/2011, nuk është një zbatim i duhur i këtyre vendimeve. Kolegji Administrativ është shprehur se është detyrë funksionale e gjykatës administrative të identifikojë saktë ligjin që rregullon marrëdhënien e punësimit në administratën publike dhe të përcaktojë se mosmarrëveshja e lindur rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës në raport me ligjin nr. 152/2013, por shpërblimi i përcaktuar në dispozitat e atij kodi duhet të njihet/jepet vetëm mbi bazën e kërimit të punëmarrësit, përfundim ky që arrihet përmes interpretimit pajtues midis parimeve të gjykimit administrativ me ato të gjykimit civil.

37. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, pavarësisht se është vënë në lëvizje mbi rekursin e palës së paditur, nuk e ka shqyrtuar çështjen brenda shkaqeve të parashtruara në të, sikurse përcakton neni 473/a, paragrafi i parë, i KPC-së, dispozitë kjo e zbatueshme edhe për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Kjo dispozitë mishëron parimin e së drejtës procedurale *non ultra petita partium*, që në këtë rast nënkupton se Gjykata e Lartë nuk mund të shqyrtojë çështje (të ligjit) që nuk ngrihen nga palët në recurs, rregull ky që përcakton edhe kufijtë e juridiksionit rishikues të saj. Megjithatë, si përjashtim, ajo lejon zgjerimin e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë përtej kufijve të rekursit, vetëm atëherë kur ligji e parashikon ndryshe. Pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar në këtë drejtim, duke mos treguar se përse ishte përpara rastit përjashtimor që i jep të drejtë asaj, pra e lejon për zgjerimin e shqyrtimit të çështjes përtej kufijve të rekursit që e kishte vënë në lëvizje.

38. Po kështu, Gjykata vëren se zgjerimi i shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë përtej kufijve të rekursit ka të bëjë me një çështje, e trajtuar prej saj si çështje ligjore, për të cilën kërkuar nuk i është kërkuar të shprehet. Konkretisht, Gjykata e Lartë, në seancën gjyqësore të zhvilluar në dhomën e këshillimit, ka vënë në diskutim kryesisht nëse përmes padisë së tij kërkuar ka kërkuar zgjidhjen e atyre pasojave nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës për të cilat gjykata e apelit ka disponuar në

favor të tij, duke arritur në përfundimin se në fakt ato nuk janë kërkuar.

39. Gjykata vëren se përcaktimi i qartë i objektit të padisë dhe në këtë kuptim i objektit të mosmarrëveshjes është parakusht për fillimin e procesit gjyqësor dhe për shqyrtimin e padisë. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë, fillimisht, nuk ka vlerësuar që objekti i mosmarrëveshjes së parashtruar për zgjidhje nga kërkuar të ketë qenë i errët ose i paqartë. Ajo e ka shqyrtuar padinë, duke arritur në përfundimin se për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, kërkuar nuk i ka lindur ndonjë e drejtë që mund të rivendosej gjyqësisht, qoftë sipas ligjit të veçantë (nr. 152/2013), ashtu dhe sipas Kodit të Punës. Gjykata e apelit më pas, pavarësisht mënyrës së ndërtimit të mbrojtjes nga kërkuar, konkretizuar në kërkimet pjesë e objektit të padisë, duke u mbështetur në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë (Kolegjit Administrativ), në trajtimin e rasteve të ngjashme (në të cilat janë bërë referime edhe në vendimet unifikuese nr. 7/2011 dhe nr. 3/2012), ka vlerësuar të zbatohet dispozitat e Kodit të Punës me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes palëve ndërgjyqëse, duke i njohur kërkuar, sipas këtij kodi, të drejtën e shpërblimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Në rekursin e saj pala e paditur nuk ka parashtruar ndonjë kundërshtim për objektin e mosmarrëveshjes të zgjidhur nga gjykata e apelit, ndërkohë që kërkuar është pajtuar me qëndrimin e asaj gjykate, duke mos paraqitur recurs ndaj vendimit të saj dhe as kundërrecurs ndaj rekursit të palës së paditur. Në këtë kuptim, për çështjen e vënë në diskutim nga Gjykata e Lartë, pra nëse përmes padisë është kërkuar ose jo shpërblim për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, kërkuar nuk i janë kërkuar më parë sqarime specifike, ndërkohë që gjykatat e faktit, në veçanti ajo e apelit, ka pranuar se nga ai është kërkuar një shpërblim i tillë.

40. Gjykata, pa marrë përsipër të vlerësojë një çështje të tillë, vëren se ligji procedural civil dhe pikërisht neni 473/a, paragrafi i dytë, i KPC-së, përcakton se kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtrësive të tyre për ato çështje të ligjit të vëna në diskutim. Në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë



nuk rezulton t'i ketë kërkuar paraprakisht mendim kërkesit për çështjen e vënë nga ajo në diskutim kryesisht, ndërkohë që kërkuesi, referuar parashtrimeve në kërkesë, ka argumentet e veta në lidhje me këtë çështje. Nga ana tjetër, në kontekst të rrethanave të rastit në shqyrtim dhe në raport me detyrimin ligjor si më lart, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar as se përse në këtë rast marrja paraprakisht e mendimit të palëve, në veçanti nga kërkuesi, nuk ka qenë i detyrueshëm, pra se nuk gjente zbatim neni 473/a i KPC-së.

41. Gjykata çmon se zgjerimi i kufijve të çështjes dhe në këtë kuptim i kufijve të juridiksionit, i shoqëruar me mungesën e arsytimit në këtë drejtim, si dhe mosdhënia mundësi kërkesit për të parashtruar mendimin e tij për një çështje që ka rezultuar thelbësore për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes nga Gjykata e Lartë, zgjidhje kjo në disfavor të tij, i ka cenuar atij të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtëm të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, krahas standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor në kushtet e mosparashtrimit të arsyeve për këto aspekte ligjore të procesit të zhvilluar prej saj.

42. Gjithashtu, Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk paraqitet konsistent, pasi i mungon koherenca në dy drejtime. Së pari, nga njëra anë, ajo pohon detyrimin e gjykatës së apelit për respektimin e parimit të së drejtës procedurale *non ultra petita partium*, pra për të mos u shprehur tej kërtimeve në padi dhe në objektin e ankimit të palës/palëve, kurse, nga ana tjetër, ka zgjidhur mosmarrëveshjen mes palëve për pretendime që nuk janë ngritur në rekursin e palës së paditur, duke mos arsyetuar në lidhje me respektimin e këtij parimi nga vetë ajo. Së dyti, ajo, nga njëra anë, pohon se arsyetimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë nuk është ai i duhuri, si dhe se argumenti i përdorur prej saj nuk është i mjaftueshëm për rrëzimin e padisë së kërkesit, ndërsa, nga ana tjetër, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të asaj gjykate.

Për më tepër, Gjykata e Lartë ka marrë përsipër të plotësojë arsytimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ku argumenti shtesë i përdorur prej saj është një argument procedural, pikërisht mungesa e atyre kërtimeve konkrete në padi, argument ky që kurrësi nuk ka të bëjë me bazueshmërinë në themel të padisë. Gjykata vëren edhe mungesë arsytimi në vendimin e Gjykatës së Lartë për sa ajo shprehet se referimi i bërë nga gjykata e apelit në vendimin nr. 190/2014 të Gjykatës së Lartë dhe vendimit unifikues nr. 7/2011, nuk është një zbatim i duhur i këtyre vendimeve, ndërsa ka anashkaluar të tregojë arsyet se përse gjykata e apelit ka gabuar në përfundimin e arritur mbi bazën e kësaj praktike gjyqësore. Për më tepër, ky moment lidhet pikërisht me çështjen e vënë në diskutim kryesisht prej saj dhe, si i tillë, nuk mund të anashkalohej vetëm me parashtrimin e qëndrimit për rastin në shqyrtim, pa marrë përgjigje mjaftueshëm trajtimi i bërë nga gjykata e apelit në këtë drejtim dhe për të cilin palët nuk kishin paraqitur kundërshtime. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se edhe në këtë drejtim, arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë nuk përmbush mjaftueshëm standardet kushtetuese të arsytimit të vendimit gjyqësor.¹

43. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtëm të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, si dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është i bazuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet².

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe

¹ Gjyqtaret Holta Zaçaj dhe Fiona Papajorgji për këto argumente votuan për pranimin e kërkesës vetëm për sa i takon cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

² Gjyqtarja Elsa Toska votoi për rrëzimin e kërkesës me argumentet se: i. nuk ka cenim të standardit të gjykatës së caktuar me ligj, pasi Gjykata e Lartë ka ushtruar kompetencat brenda kufijve kushtetues të interpretimit të

ligjit material dhe procedural dhe për rrjedhojë të lidhur me këtë konkluzion nuk ka cenim as të së drejtës për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar; ii. nuk ka cenim të standardit të arsytimit, pasi nuk konstatohen shkelje të nivelit kushtetues të alogjizmit, pamjaftueshmërisë në analizën e çështjes ose të arbitraritetit të dukshëm të interpretimit të ligjit, aq sa vendimi objekt kundërshtimi të jetë i cenusshëm për këto shkaqe.



funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2649, datë 3.11.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 7.11.2023.

Shpallur më 7.12.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sonila Bejtja

Anëtar kundër: Elsa Toska

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë